

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS

Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 03.03.2025 DERI MË 07.03.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndërprerjen e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-5358-2025
2.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të references për aktivitetin e prokurimit: "Faza përfundimtare e rregullimit të hapësirës së ish objekteve të AVP-së, si dhe funksionalizimi i objekteve të lokaleve afariste dhe të tregut të gjelbër".	NRP-02-5361-2025
3.	Vendim për miratimin e kërkesës për strehim të përkohshëm emergjent në kohëzgjatje prej 6 muajve.	NRP-02-5363-2025
4.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-5365-2025
5.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie të subvencioneve për ndihma financiare për vitin 2025.	NRP-02-5366-2025
6.	Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës.	NRP-02-5371-2025
7.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të references për aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Rahovec-Drenoc-Senoc-Pastasel-Polluzhë".	NRP-02-5377-2025
8.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull: "Lot-1-Riparimi i monumenteve kulturore-historike".	NRP-02-5380-2025
9.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-5384-2025
10.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-5385-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, si dhe kërkesës së Qemajl Krasniqit, me nr. prot. 561, të datës 3.3.2025, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për ndërprerjen e pushimit nga puna pa pagesë e Qemajl Krasniqit nga Ratkoci, me nr. prot. 561 të datës 03.03.2025, i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: përgjegjës i Sektorit për Rini dhe Sport në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
2. Qemajl Krasniqi, kthehet në punë dhe në detyrat e punës nga data 3.3.2025.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i kthehen të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, para skadimit të vendimit me nr. prot. 5023, të datës 20.11.2024, për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.
4. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta kthejë në listën e pagës zyrtarin Qemajl Krasniqi nga data 3.3.2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

Arsyetim

Qemajl Krasniqi, i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: përgjegjës i Sektorit për Rini dhe Sport në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesën me nr. të prot. 561, të datës 3.3.2025, me të cilën ka kërkuar ndërprerjen e pushimit pa pagesë nga data 3.3.2025.

Kërkesën, i lartpërmenduri e ka parashtruar pasi i ka kryer obligimet familjare për të cilat ka marrë pushim pa pagesë, sipas vendimit me nr. prot. 5023, të datës 20.11.2024.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarë Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimeve dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, është konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet për aprovimin e kërkesës.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Me vendim të njoftohen:

- ***Qemajl Krasniqi,***
- ***Njësia e Personelit,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Faza përfundimtare e rregullimit të hapësirës së ish-objekteve të AVP-së, si dhe funksionalizimi i objekteve të lokaleve afariste dhe të tregut të gjelbër"

1. Proing & Partners SH.P.K., **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Faza përfundimtare e rregullimit të hapësirës së ish-objekteve të AVP-së, si dhe funksionalizimi i objekteve të lokaleve afariste dhe të tregut të gjelbër".
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;

- 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.
4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 11.03.2025.
 5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
 6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Proing & Partners SH.P.K.,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *Njësia e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5363 Nr. i faq./Br.str/No.pg 39

Data/Datum/Date 04 / 03 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së Liridon Isakaj me Nr.Prot. 2764 të datës 28.8.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e z. [REDACTED] nga fsh. Kaznik, Komuna e Rahovecit për strehim të përkohshëm emergjent si rast në nevojë sociale në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, respektivisht prej datës 1.3.2025 deri me datë 1.9.2025, tek familja strehuese [REDACTED] nga Rahoveci në Rr. Xhelal Hajda - Toni.
2. Pagesa në emër të qirasë mujore do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.
3. **Autorizohet** Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit që të lidh marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë.
4. Përfitues sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi është z. [REDACTED] së bashku me bashkëshorten [REDACTED] dhe fëmijë [REDACTED].
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit ka pranuar kërkesë nga z. [REDACTED] për ndihmë për strehim pasi që nuk ka shtëpi ku të jetojë pasi që nga të ardhurat e ndihmës sociale nuk mund të ndërtojë shtëpi.

DSHPS ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka vizituar familjen në nevojë me ç'rast ka konstatuar se kjo familje është duke jetuar përkohësisht në një shtëpi me qira dhe në kushte të vështira ekonomike.

Andaj, duke marrë parasysh nevojën për ndihmë të familjes në nevojë të z. [REDACTED], e cila është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike, dhe se e njëjta e ka të pamundur mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe pagesën e qirasë, është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- [REDACTED]
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDACTED] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0007580/25, e dt. 28.02.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[REDACTED] nga Rahoveci me datë 28.02.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 22.02.2025 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [REDACTED] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [REDACTED], nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5366 Nr. i faq./Br.str./No.pg 39

Data/Datum/Date 06 / 03 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 7 paragrafi 1 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit Nr. 1427 të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënien e subvencioneve për ndihma financiare për vitin 2025

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënien e subvencioneve për ndihmat financiare për vitin 2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Dr. Ardian Morina, kryesues,
 - 1.2. Skender Hamza, anëtar,
 - 1.3. Goneta Mustafa, anëtare,
 - 1.4. Ekrem Bytyqi, anëtar,
 - 1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie të subvencioneve për ndihma financiare, për banorët rezidentë, për përballimin e shpenzimeve sipas kriterëve të parapara në nenin 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit Nr. 1427, të datës 28.4.2017.
3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në legjislacionin për financat publike dhe në Rregulloren Nr. 1427, të datës 28.04.2017, për kushtet, kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve.
4. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për dhënie të subvencioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kriterëve për dhënien e subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DShPS-ja, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5371 Nr. i faq./Br.str./No.pg 40

Data/Datum/Date 04 / 03 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyratë Publike Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM
PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

1. **VESNA MILJKOVIC** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për kthim, në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS**, nga data 15.3.2025.

2. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave, nga data 15.3.2025.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Punëtores **VESNA MILJKOVIC** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për kthim, në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS**, nga data 15.3.2025.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e Personelit, ka konstatuar që punëtori i lartpërmendur, më datë 14.3.2025, arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtores **VESNA MILJKOVIC**, nga data 15.3.2025, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga se u tha më lart, kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, punëtori ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.


Kopja e vendimit u dorëzohet:

1. Punëtores,
2. Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
4. Dosjes personale, dhe
5. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel - Polluzhë"

1. Proing & Partners SH.P.K., **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel - Polluzhë".
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 14.3.2025.
5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Proing & Partners SH.P.K.,*
- *Drejtoria për Shërbime Publike,*
- *Njësia e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5380 Nr. i faq./Br.str./No.pg 40
Data/Datum/Date 06 / 03 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 562 të datës 3.3.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull: “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanëshme me titull “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314.
2. Ndërprerja e kontratës me marrëveshje të dyanëshme sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të ngjarjes së shkaktuar nga forca madhore, që është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit, Komuna e Rahovecit (në vazhdim Autoriteti Kontraktues), ka nënshkruar Kontratë publike kornizë me Operatorin Ekonomik “Sinani - Ing” SH.P.K. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Haradin Krasniqi (në vazhdim Kontraktuesi), me titull “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314 me Nr. Prot. 4494 të datës 20.9.2021.

Pas nënshkrimit të kontratës Autoriteti Kontraktues ka kryer punët sipas kushteve të parapara në kontratë.

Mirëpo, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, situata ka ndryshuar, sepse artikujt të cilat janë objekt i punimeve sipas kësaj kontrate kanë pësuar rritje të mëdha në çmimin e furnizimit në treg.

Për këtë arsye, Kontraktuesi, ka parashtruar kërkesë me datë 6.2.2025, tek menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, të cilët janë caktuar me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull: “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore

- historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314, me arsyetimin, se çmimet e produkteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës në vitin 2021, kanë pësuar rritje të mëdha në vitet në vijim në masën prej 50%, dhe me këtë rast është e pamundur kryerja e punimeve sipas kontratës.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës me datë 3.3.2025, i është drejtuar Kryetarit të Komunës me kërkesë/rekomandim me për ndërprerjen e kontratës me titull “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314, sipas kërkesës së arsyetuar të operatorit ekonomik.

Për këtë arsye, pas kërkesës së pranuar të Kontraktuesit si dhe rekomandimit të menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të kontratës me Nr. Prot. 562 të datës 3.3.2025 për ndërprerjen e kontratës me titull “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314, për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve të produkteve bazë për ndërtim në bursa ndërkombëtare poashtu edhe në Republikën e Kosovës, pas paraqitjes së Pandemisë COVID-19, si dhe duke u bazuar në nenin 38 të kësaj kontrate në të është e paraparë “forca madhore” e cila është shkaktuar pas datës kur kontrata ka hyrë në fuqi.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 4494 të datës 20.9.2021 me titull “Lot 1 – Riparimi i monumenteve kulturore - historike” me nr. të prokurimit 623-21-6443-5-2-1/C314.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***





Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0008093/25, e dt. 06.03.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[REDAKTUAR] nga Rahoveci me datë 06.03.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 02.03.2025 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [REDAKTUAR] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [REDAKTUAR], nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0007968/25, e dt. 05.03.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [REDAKTUAR] nga Rahoveci me datë 05.03.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 03.03.2025 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.** [REDAKTUAR] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.** [REDAKTUAR], nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**

Procedura Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
P.Nr./Br./No 5385 Nr. 1faq/Br.str/No.pg 41
Data/Datum/Date 7/3/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0007968/25, e dt. 05.03.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] nga Rahoveci me datë 05.03.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 03.03.2025 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.** [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.** [redacted], nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**



